

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BIRN: I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/birn-i-derguari-i-trump-me-mision-lobimi-ne-tirane-per-rizgj-edhjen-e--i514154
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 20:27:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:24:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	71f651d26f8e89856292266eb24d4075af42cddb4f54324a3ee7e39b0c6fb4
TEKSTI	6f875a4fff24cf77ab3865c3985d637feb5084fa7495cdf6870809ecbab25704
PAMJA	777191e9eb805727aca9389e00d344b99aee02bc6ad556e88385b188fe1e90d9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5d854994e0af63e76104bef1b5338dbf322fc7fefae339d63169ab1a84744559
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5d854994e0af63e76104bef1b5338dbf322fc7fefae339d63169ab1a84744559>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

2 ORE ME PARE

Më 16 shtator jepet vendimi për Thačin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

7 ORE ME PARE

"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

11 ORE ME PARE

Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

Aktualitet

BIRN: I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

Dy burrat pozuan duke buzëqeshur përballë pllakatës në hyrje të Federatës, e njohur si "Shtëpia e Futbollit", ndërkohë që Zampolli veçoi me këmbëngulje me gishtin e tij tregues një emër mbi pllakë: Gianni Infantino, President i FIFA-s.



14 Shtator 2026, 22:24
Nga E. D



TIRANË- Më 8 shtator, i dërguari special i Presidentit të SHBA-ve për Partneritetet Globale, Paolo Zampolli zhvilloi një takim të papritur me presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit, Armando Duka.

Dy burrat pozuan duke buzëqeshur përballë pllakatës në hyrje të Federatës, e njohur si "Shtëpia e Futbollit", ndërkohë që Zampolli veçoi me këmbëngulje me gishtin e tij tregues një emër mbi pllakë: Gianni Infantino, President i FIFA-s.

Edhe pse takimi u prezantua zyrtarisht nën petkun e "diplomacisë sportive", BIRN mësoi se pas tij fshihet një mision lobimi.

Përtej rolit si i dërguar i Shtëpisë së Bardhë, Zampolli është një avokat i hapur dhe i zjarrtë i Gianni Infantinos dhe gjatë vizitës së tij në Tiranë, ai kërkoi mbështetje për rizgjedhjen e tij për një mandat tjetër 4-vjeçar në krye të FIFA-s.

Vizita e Zampollit në Tiranë u zhvillua në një moment delikat për kreun e FIFA-s, i cili po përballlet me tërheqje të njëpasnjëshme të mbështetjes nga federatat europiane të futbollit për shkak të një propozimi të dështuar për shitjen e të drejtave të Kupës së Botës tek një konsorcium privat.

Federata Shqiptare e Futbollit e ka tërhequr gjithashtu zyrtarisht në gusht mbështetjen e dhënë më parë për Infantinon për një mandat të ri në krye të FIFA-s.

editoriale

Irena Begiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 14 SHTATOR 2026, 22:03

Audiopërgjimi zbardh skemën si Roni Yeffet instruktonte ukrainasit dhe rusët: Shkoni në Vlorë dhe thoni se përfaqësoni një kompani amerikane

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 20:09

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Përfshirja e një të dërguari të Shtëpisë së Bardhë për të lobuar për kreun e FIFA-s e bën këtë vizitë kontroverze, pasi rezikon të shkelë një nga parimet më strikte të statutit të futbollit botëror, ndalimin e ndërhyrjes së politikës shtetërore në pavarësinë e federatave.

Vetë Zampolli e përshkroi vizitën e tij në zyrat e FSHF-së me fjalët: "Diplomacia sportive 'America First' [Amerika e Para] në veprim".

I pranishëm në takimin mes Zampollit dhe Dukës, Ilir Kulla, një ish-këshilltar i lartë shtetëror dhe ekspert i sigurisë, pranoi se mandati i Infantinos kishte qenë pjesë e takimit, por shtoi se për këtë duhej të fliste kreu i FSHF-së.

"Ka një të vërtetë, por besoj që i takon Dukës," tha Kulla përmes një mesazhi.

"Infantinon e kanë mik të përbashkët dhe është mik i Trump-it," shtoi më tej ai.

E pyetur për lobimin e Zampollit në Shqipëri, FIFA mohoi përmes një zëdhënësi çdo përfshirje të mundshme të kreut të saj.

"Presidenti i FIFA-s nuk ka dijeni për këtë çështje dhe nuk i ka dhënë udhëzime askujt," tha zëdhënësi.

Kreu i FSHF-së, Armando Duka ishte i paarritshëm për koment, ndërkohë që një zëdhënës i FSHF-së i tha BIRN-it se përsa i përket Infantinos, institucioni shqiptar mban të njëjtin qëndrim si qeveria europiane e futbollit: "Ne kemi qëndrim të unifikuar me UEFA-n."

Mbështetje për Infantinon

Zampolli është një biznesmen italiano-amerikan, i njohur gjerësisht si mik i afërt i presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe si njeriu që i ka prezantuar këtij të fundit bashkëshorten e tij, Melania.

Megjithatë, profili i tij publik ka pasur edhe hije dyshimi, teksa emri i tij është lakuar në media për shkak të përmendjes në rrethin e kontakteve të miliarderit të akuzuar për abuzime seksuale me të mitur, Jeffrey Epstein.

Përtej rolit si i dërguar i Shtëpisë së Bardhë, Zampolli është pozicionuar hapur përkrah Infantinos. Në një artikull të gjatë të publikuar së fundmi, "Faji i vërtetë i Gianni Infantinos: Hapja e futbollit ndaj botës", Zampolli e mbron Infantinon si një kampion të vendeve të vogla që po lufton monopolin europian.

Në këtë material, ai argumenton se fushata kundër Infantinos është "shkëputur nga perspektiva dhe faktet" dhe thekson se faji i vërtetë i presidentit të FIFA-s është sfidimi i një ekonomie globale ku, Europa gjeneron rreth 70 për qind të të ardhurave dhe kërkon ta kthejë këtë sukses në një "mur që mbron privilegjin nga pjesa tjetër e botës".

Zampolli është bërë edhe më herët lajm ndërkombëtar në lidhje me futbollin.

Para fillimit të Kupës së Botës në SHBA, Meksikë dhe Kanada që përfundoi në korrik, ai propozoi që Irani, me të cilin SHBA-të ishin në konflikt, të zëvendësohej në këtë garë nga Italia. Por propozimi i tij u përqesh dhe u rrëzua, pasi nuk mbështetej në asnjë prej rregullave të lojës.

Përplasja mes UEFA-s dhe Infantinos

Përpjekja e të dërguarit të Trump-it për të siguruar mbështetje për kandidimin e Infantinos vjen si pasojë e një krisjeje të fortë mes UEFA-s dhe FIFA-s. Krisja erdhi pas propozimit të dështuar të Infantinos për strukturën e re të investimeve, e cila konsistonte në një plan për t'i shitur të drejtat e turneve të FIFA-s, përfshirë Kupën e Botës, te një konsorcium privat investitorësh në këmbim të miliarda dollarëve investime – një lëvizje që u kundërshtua ashpër nga komuniteti i futbollit për mungesë konsultimesh paraprake, duke e detyruar kreun e FIFA-s ta tërhiqte atë.

Pas kësaj përplasjeje, që erdhi menjëherë pas përfundimit të Kupës së Botës, UEFA dhe një sërë federatash pjesë e saj, përfshirë Gjermaninë, Anglinë, Francën dhe një sërë vendesh të tjera, tërhoqën mbështetjen për Infantinon.

FSHF iu bashkua këtij grupi më 6 gusht 2026, kur Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, i dërgoi një letër zyrtare Sekretarit të Përgjithshëm të FIFA-s, Mattias Grafström, për t'i komunikuar tërheqjen e mbështetjes. Përmes këtij dokumenti, FSHF njoftonte revokimin e mbështetjes së dhënë më herët, konkretisht më 20 maj 2026, për kandidaturën e Gianni Infantinos për një mandat të ri katërvjeçar në krye të institucionit.

Në letër theksohej se vendimi ishte marrë pas "konsultimeve të mëtejshme të brendshme dhe një shqyrtimi të kujdesshëm". Ndonëse FSHF përdori një gjuhë diplomatike në shkresë, tërheqja vjen në vijim të qëndrimeve të ashpra të federatave europiane lidhur me proceset e qeverisjes së FIFA-s.

Në rrugë zyrtare, FSHF zgjodhi ta mbajë çështjen e lobimit jashtë vëmendjes së publikut, duke u fokusuar te njoftimet për diplomacinë sportive. UEFA refuzoi të përgjigjej, duke sugjeruar që pyetjet duhej t'i drejtoheshin Tiranës zyrtare.

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 15:41

"Mbaje mend do të vras"/
Kërcënohet me vdekje
gazetari Osman Stafa, Policia:
Materialet u referuan në
Prokurori për 3 vepra penale

më të klikuarat

"Mbaje mend do të vras"/
Kërcënohet me vdekje
gazetari Osman Stafa,
Policia: Materialet u
referuan në Prokurori për 3
vepra penale



"Të q***a robt, o Edi"/
Rama kap të riun nga qafa
dhe ia dorëzon policisë, çfarë
ndodhi në Aeroportin e
Napolit? (VIDEO)

Vajza e saj 10 muajshe ishte
me temperaturë të lartë/
Gazetarja rriëen
eksperiencën në Pediatrinë e
QSUT-së: Prindërit
përballesh me arrogancë dhe
poshtërim

Ilir Meta del nga kafazi/
Apeli i GJKKO pranon
kërkesën: Gjatë seancave do
qëndrojnë krah avokatit

insights

Ola Xama

Republika e 1
euroshit ku Rama
zgjedh kush bëhet
biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi
shqiptar për tu
përshtatur me
tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e
"shkarkoi" sot Edi
Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E
TRUPROJAVE/ Nga
tokat te klubet VIP:
Rrjoll, Zvërnec,
Sarandë e Ksamil
nën hijen e "burrave
të zinj"

Moti

Powered by tomorrow.

Axhenda e ngjeshur dhe "Shteti Bektashi"

Gjatë vizitës në Tiranë, Zampolli nuk u mjaftua vetëm me futbollin, por zhvilloi një axhendë të ngjeshur takimesh me përfaqësues të institucioneve shtetërore, klerikë dhe drejtues të sportit.

Në daljet e tij publike, ai u përfshi edhe në debatin më të fundit gjeopolitik dhe fetar në vend, lidhur me çështjen tejet kontroverze të krijimit të "Shtetit Bektashi" brenda kufijve të Tiranës.

"Mendoj se është një projekt i shkëlqyer. E kam dëgjuar kryeministrin të flasë, dëgjova shenjtërinë e tij [kreun e bektashinje] dhe njerëzit tuaj vendosin ose do të vendosin. Mendoj se komuniteti ndërkombëtar respekton vendimin e popullit shqiptar," tha Zampolli për gazetarët pas takimit.

Kjo u pasua nga takime të tjera, duke përfshirë kreun e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Fidel Ylli, Ministren e Ekonomisë dhe Inovacionit si dhe zv. ministrin për Sportin me një axhendë zyrtarisht të fokusuar te partneritetet globale, investimet dhe diplomacia amerikane./BIRN

donald trump

Sondazh

Poll

Aktualitet

14 Shtator 2026, 22:25

Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të tronditë raportet e Kosovës me Perëndimin

Ish-komandantët e UÇK-së Dhomat e Specializuara të Kosovës pritet të shpallin të mërkurën aktgjykimin në...

Protesta e 107-të/ Qytetarët vendosen përballë bllokut të sigurisë, thirrje: Arrestoni Ramën, lironi qytetarët

Aktualitet

14 Shtator 2026, 21:49



"Shkoni në Vlorë dhe bëni çfarë të doni" / Përgjimet e reja të Roni Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua! Mos nisni asnjë letër zyrtare, merrem unë me ta (VIDEO)

Aktualitet

14 Shtator 2026, 21:37

Rrahja barbare e indianit në Greqi, tre të arrestuar, mes tyre dy shqiptarë

Aktualitet

14 Shtator 2026, 21:22

Pesë shkolla në Astir? Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar

Aktualitet

14 Shtator 2026, 20:43

Aktualitet

14 Shtator 2026, 20:50

Përfundojnë fjalimet para Kryeministrit, qytetarët marshojnë drejt bllokut të sigurisë, thirrje: Lironi çunat e diasporës

Pamje nga marshimi TIRANË- Protesta në Tiranë ka shënuar 107 ditë të revoltës qytetare. Pas fjalimeve përballë...

Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë

Aktualitet

14 Shtator 2026, 20:09

"Grushti i policit na qëlloi të gjithëve ne"/ Protestuesi: E keqja e këtij vendi është Edi Rama

Aktualitet

14 Shtator 2026, 20:22

"Nuk kanë forca të menaxhojnë situatën në boulevard" / Protestuesi: Frontin nuk do e lëshojmë, jemi afër fitores

Aktualitet

14 Shtator 2026, 19:52

"Shqipëria është në udhëkryq" / Protestuesi: Antishqiptari me emrin Edi Rama po bën ligje që vënë në rrezik territorin

Aktualitet

14 Shtator 2026, 19:48

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.